



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 79/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me zyrtaren ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, dhe Koalicionit LDK-AKR, dega në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1,800.00 (njëmijetëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 05.06.2017, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkëngjitur si dëshmi fotografitë e printuara nga vendi i ngjarjes. Parashtruesi i ankesës potencon se me datën 04.06.2017, në Rrugën “Mustafë Hoxha” në Prishtinë, monitoruesi i tyre ka hasur në postera të kandidatit për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga koalicioni LDK-AKR, të ngjitur në objekt publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33, paragrafi 1, pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se Koalicioni LDK-AKR, ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur poster të kandidatit për deputet në hapësirë publike. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkëngjitur dy fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë koalicioni LDK-AKR, të datës 06.06.2017, ka pranuar shkeljen pretenduar në ankesë duke arsyetuar se e kemi urdhëruar kandidatin që të ndërmarr veprime përmirësuese, duke kërkuar nga PZAP-i që të mos i shqiptojë gjobë subjektit të tyre politik dhe se koalicioni LDK-AKR pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, ka ndërmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur një foto nga vendi ku janë larguar posterat.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteret e kandidatit për deputet nga radhët e koalicionit LDK-AKR, janë vendosur në objekt publik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e Koalicionit LDK-AKR, dega në Prishtinë, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteret e kandidatit për deputet nga koalicionit LDK-AKR, janë vendosur në objekt publik të qytetit. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë koalicioni LDK-AKR, në përgjigjen në ankesë të datës 06.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti posteret e kandidatit për deputet nga ky koalicion LDK-AKR, janë vendosur në objekt publik. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se koalicionit, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që i kanë tërhequr posteret në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 79/2017 më datën 07.06.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.